



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: "SPIN TV" SH.P.K
Numri Unik Identifikues: 811023811
Pronar: Ramadan Ahmeti
OSHMA: SPIN TV
Adresa: Rr Adem Jashari, nr. 27 Shtime

Emri i Biznesit: Tau – GeN – Ingjinjering SH.P.K
Numri Unik Identifikues: 810536328
Kandidati për pronar: Ilaz Collaku.
OSHMA: SPIN TV
Adresa: Varosh, Lipjan

VENDIM

për ndryshim të pronësisë të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) SPIN TV, me seli në Shtime



Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. OSHMA SPIN TV është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim të programeve televizive përmes operatorëve të shpërndarjes, me seli në Shtime. KPM, me vendimin e datës 15 mars 2017, i ka lëshuar licencën OSHMA Spin TV për një afat prej dhjet (10) vitesh.
3. Spin TV me datën 6 janar 2023, ka parashtruar kërkesë me anë të së cilës ka kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e pronësisë dhe kalimin e saj nga biznesi "SPIN TV" SH.P.K. me numër të biznesit 811023811 dhe me pronar z. Ramadan Ahmeti tek biznesi Tau – GeN – Ingjinjering SH.P.K. me numër unik identifikues 81053632 me pronar z. Ilaz Collaku.
4. Për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmarrje të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, si dhe grumbullimit të rasteve, kërkesa OSHMA SPIN TV, nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.

Arsyetim

5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së".

6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
8. Komisioni konstaton se sipas asaj që është deklaruar përmes kërkesës për ndryshim të pronësisë arsye për këtë ndryshim është gjendja shëndetësore dhe financiare e pronarit aktual.
9. Komisioni konstaton se në mesin e dokumenteve të kërkuara për ndryshim të pronësisë është dorëzuar deklarata e kandidatit për pronarë i cili shprehë gatishmërinë e tij të pranojë pronësinë dhe të punojë në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së. Gjithashtu, kandidati për pronarë ka dorëzuar edhe dëshmi lidhur me dënimet penale si dhe ka plotësuar deklaratën për pajtueshmërinë me Ligjin dhe aktet nënligjore lidhur me kualifikimin për marrjen e licencës si dhe ndryshimet në pronësi.
10. Komisioni konstaton se kandidati për pronar të SPIN TV ka dorëzuar plan të qartë të biznesit dhe gjithashtu, edhe ka bashkangjitur dëshmi mbi prejardhjen e mjeteve financiare (dokument nga banka) të cilat i mundësojnë realizimin e planit investiv.
11. Komisioni konstaton se SPIN TV nuk ka obligime financiare ndaj KPM-së.
12. Komisioni konstaton se SPIN TV ka kryer pagesën e tarifës administrative për ndryshim të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
13. Komisioni konstaton se në certifikatën e biznesit të verifikuar në faqen e internetit të ARBK shihet se nuk ka ndryshime të pronësisë, pra figuron emri i pronarit sipas licencës z. Ramadan Ahmeti.
14. Komisioni konstaton se kërkesa për ndryshimin e pronësisë së SPIN TV është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa i plotëson kushtet dhe kriteret për miratim.


Vendim

15. Komisioni merr vendim që të miratoj kërkesën e OSHMA SPIN TV për ndryshimin e pronësisë dhe kalimin e saj nga biznesi “SPIN TV” SH.P.K. me numër të biznesit 811023811 dhe me pronar z. Ramadan Ahmeti tek biznesi Tau – GeN – Ingjinjering SH.P.K me numër unik identifikues 81053632 me pronarë z. Ilaz Collaku.
16. Pronari i ri OSHMA SPIN TV duhet ti përmbahet deklaratës të nënshkruar mbi pajtueshmërinë përmes së cilës është zotuar se nuk do të bëj ndryshim të pronësisë pa miratimin me shkrim paraprak të KPM-së dhe se çdo ndryshim në pronësi, pa miratim

paraprak me shkrim nga KPM do të ishte shkelje e Ligjit dhe akteve nënligjore si dhe kushteve të licencës dhe e cila shkelje do të rezultojë me masa të menjëhershme sanksionuese të cilat mund të çojnë deri në ndërprerjen e licencës.

17. Të gjitha parametrat tjera të licencës së OSHMA SPIN TV, përveç ndryshimit të pronësisë, do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.

18. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



10.11.2023

Datë